

VENDIM
Nr. 237, datë 2.11.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMI I TË GJITHA
OST-ve PËR NJË METODOLOGJI TË OFRIMIT TË TË DHËNAVE TË
GJENERIMIT DHE TË NGARKESËS, NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË
RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2016/1719, TË DATËS 26 SHTATOR 2016,
‘PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË
AVANCË”**

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “F” dhe të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë””,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 7329 prot., datë 23.10.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës, në përputhje me nenin 17, të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë””.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përkatësisht neni 56 dhe neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht nenit 117, “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me nenin 19 të dokumentit origjinal.

- Dokumenti vjen nga OST sh.a. në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018, me objekt: “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë””, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 20.8.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë të Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe i propozuar për miratim si akt më vete.

- Dokumenti i përbërë nga 19 nene saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës së nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian, analiza e sigurisë, me qëllimin përcaktimin e kapaciteteve të lira në avancë, por edhe ato të ditës në avancë apo brenda ditës.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjitha OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat do ta përcjellin për miratim te autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen, gjithashtu, që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator, duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të

ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, në përputhje me nenin 17, të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, 'Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë''' (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti